

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Asgjë e re nga Edi Rama
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/27/asgje-e-re-nga-edi-rama/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:37:24 UTC Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:35:33 UTC Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e9ca8630a6561454942cd93982e82feb02476a0d4e2bf4fde005214cf6dcf46
TEKSTI	c77f8a3f824716a884652eb9b62b4ca29c3c100b6a6ca1b4010e016143ca135c
PAMJA	0f2d23da8babfec5c23c91780a073c42976b5f4be9c05e66c446e744a09c21d3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	34312d8c9301fabab212c7df282393b97391054de48f895381fab5cf9ed4f461
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728bdf8bf8d029d400ef1ab927ee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/34312d8c9301fabab212c7df282393b97391054de48f895381fab5cf9ed4f461>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Asgjë e re nga Edi Rama

20:35 : 27/09/2026 në AKTUALITET, KRYESORE, OP-ED, POLITIKE

Nga **Boldnews.al**

Monologu i fundit i Edi Ramës nga salla e tranzitit në Rinas nuk solli asgjë të re në thelbin e tij politik, por vulosi përfundimisht një doktrinë të rrezikshme: shndërrimin e dështimeve dhe skandaleve më të rënda shtetërore në propagandë për suksesin e reformës në drejtësi.

Sa herë që SPAK-u guxon të prekë bërthamën e rrethit të tij të ngushtë, kryeministri aktivizon skenarin e tij të preferuar lan duart si Ponc Pilati me shlogenin “përgjegjësia është individuale” dhe e shet kalbëzimin e pushtetit të tij si “sukses të sistemit”.

Në çdo vend tjetër normal dhe demokratik, vendosja nën arrest shtëpiak e shesës së inteligjencës kombëtare (Vlora Hyseni) për rrjedhje të informacioneve sekrete dhe lidhje të dyshimta me rrjetet e hakerave dhe krimin do të shkaktonte një krizë të thellë qeveritare. Do të kërkohej dorëheqja e menjëhershme e titullarit që e përzgjedhi me dorën e tij dhe e emëroi në krye të institucionit më delikat të sigurisë kombëtare.

Por në Shqipërinë e Edi Ramës, kjo ngjarje tragjike për sigurinë e shtetit përdoret si alibi mediatike. Nga aeroporti, pa asnjë skuqje apo reflektim moral, ai deklaroi se “korrupsioni nuk po rritet, po goditet”, duke u përpjekur politikisht të na mbushë mendjen se ky pastrim radikal po ndodh vetëm sepse ai vetë e lejoi.

Lexo edhe:[“Edi Rama, Shqipëria të urren”/ Protestuesit nisin marshimin drejt Kryeministrit](#)[Aktivisti për vizitën e Ramës në SHBA: Bota i ka 'hequr fishën', Amerika e braktisi!](#)

Megjithatë, kjo taktikë mbrojtëse ka pësuar një metamorfozë të pastër që zbulon frikën e vërtetë të kryeministrit përballë zullumeve që ka kryer kundër vendit dhe popullit të tij.

E nisi me Saimir Tahirin në 2017 duke u bërë mburojë me kartonë. Rama përdori pushtetin absolut të kartonëve në Parlament për të bllokuar kërkesën e prokurorisë për arrestim, duke e quajtur dosjen “fletërrufe”. Vetëm pasi e izoloi politikisht, pranoi t’ia dorëzonte drejtësisë.

TË GJITHA**Asgjë e re nga Edi Rama**

20:35 : 27/09/2026

**Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare**

20:24 : 27/09/2026

**Përfshihet nga flakët banesa në Fier, humb jetën i moshuari**

20:07 : 27/09/2026

**Dyshohet se abuzoi sek*ualisht me një fëmijë, arrestohet shqiptari në Amerikë /EMRI**

19:54 : 27/09/2026

**“Edi Rama, Shqipëria të urren”/ Protestuesit nisin marshimin drejt Kryeministrit**

19:41 : 27/09/2026

**Aktivisti për vizitën e Ramës në SHBA: Bota i ka 'hequr fishën', Amerika e braktisi!**

19:33 : 27/09/2026

**Edi Ramën nuk e pret askush në OKB**

19:20 : 27/09/2026

Ndërkohë në rastin e ish-zvkryeministrit Arben Ahmetaj aplikoi formulën e re lëshimin pa kushte. Ai zgjodhi distancimin total dhe cinik (“ky det nuk kalohet pa u lagur”), ndërsa sot nga arratia e sulmon duke e quajtur një “maskë karnavalesh”.

Erion Veliaj dhe Belinda Balluku dyshja e vërtet me pushtet absolut pas Ramës u mbrojt prej tij duke i shpallur luftë të hapur SPAK-it. Kur hetimet goditën dy shtyllat e vërteta të pushtetit dhe të financave të tij, Rama hodhi tej maskën e mbështetësit të reformës. Arrestimin e Veliajt e quajti antikushtetues, ndërsa tentativën për pezullimin e Ballukut e cilësoi si një “turraprap të pakuptueshëm” ku prokurorët dhe gjyqtarët u bënë bashkë për të sfiduar kryeministrin.

Njësoj si me dy beniaminët e tij të korruptuar veproi dhe për Vlora Hysenin.

Sulmi ndaj GJKKO-së nën alibinë e shtetit: Në rastin e fundit, Rama pranoi me nxitim shkarkimin e saj, por nuk nguroi të sulmonte hapur SPAK-un dhe GJKKO-në duke e quajtur masën “ekstreme”. Ai tentoi të zhvendoste fajin, duke pretenduar se ekspozimi i dosjes dëmton sekretet e shtetit.

Opozita në Gjumë dhe Heshtja e Ndërkombëtarëve

Kjo lojë e trashë propagandistike funksionon vetëm për dy arsye madhore. E para është anemia e skajshme e një opozite që nuk po di apo nuk po mundet ta kthejë këtë degradim të shtetit në një kauzë të madhe popullore. Teksa kryeministri mban monologë agresivë nga Rinas, reagimi i selisë blu mbetet brenda kornizave të konferencave sterile për shtyp, pa arritur të kapitalizojë politikisht as rënien e shërbimit sekret.

Arsyeja e dytë është heshtja bashkëfajëtare e ndërkombëtarëve. Ambasadat në Tiranë, që dikur reagonin për çdo lloj detaji, sot mbyllin sytë përpara faktit se zyrtarët më të lartë të sigurisë dhe qeverisjes po bie njëri pas tjetrit nën akuza të rënda. Për ta, “stabiliteti” i rremë i fasadës së Edi Ramës vlen më shumë se pastërtia e institucioneve të shtetit shqiptar.

Sidoqoftë edhe pse me një oppzitë anemike ose pa opozitë fare dhe me disa ambasador dordoleca të kapur prej tij Edi Rama duket i mbaruar kur e dëgjon dhe shikon të monologojë me veten.

Ajo që ra në sy në këtë dalje të fundit nuk ishte thjesht arrogance, por rënia e vetë mitit të tij. Koha e liderit karizmatik që magjepste turmat me batuta dhe e kontrollonte narrativën me një lëvizje të vetme ka perënduar. Sot, përpara kamerave në Rinas, u shfaq një Edi Ramë i zakonshëm, i lodhur, i plakur dhe i rrudhur nën peshën e skandaleve që po i plasnin përditë në duar.

Fjalët e tij nuk kanë më as forcën e dikurshme dhe as shkëlqimin e propagandës. Ky monolog nuk bind më askënd, e mbi të gjitha, nuk bind më as të vetët brenda Partisë Socialiste, të cilët e shohin kryetarin e tyre jo më si një mburojë të pathyeshme, por si një lider të konsumuar që thjesht po blen kohë në një anije që ka marrë ujë nga të gjitha anët.

Teatri i Rinasit tregoi se sa më shumë që laku i hetimeve i afrohet bërthamës së tij administrative, aq më shumë zbehet sllogani i dikurshëm “drejtësia mbi të gjitha”. Përballë degradimit të institucioneve, ku shërbimi sekret furnizonte me sekrete kriminel e organizuar, kryeministri zgjedh të thotë se “Shqipëria nuk kthehet pas”. E vërteta është se pas çdo monologu propagandistik të tillë, shteti i tij thjesht ka rënë një kat më poshtë, ndërsa vetë ai po zbrit me shpejtësi shkallët e fundit të perëndimit të tij politik.

Etiketa: Edi Rama konferencë OKB

Lajme të lidhura



“Edi Rama, Shqipëria të urren”/ Protestuesit nisin marshimin drejt Kryeministrit

19:41 : 27/09/2026




Aktivisti për vizitën e Ramës në SHBA: Bota i ka 'hequr fishën', Amerika e braktis!

19:33 : 27/09/2026



Edi Ramën nuk e pret askush në OKB

19:20 : 27/09/2026





120 ditë revoltë/ Nis protesta në Tiranë kundër Ramës

19:11 : 27/09/2026



Monologu i Ramës/ Abilekaj: Shmangu gazetarët për të mashtruar pa filtra

17:09 : 27/09/2026



Rama sulmoi drejtësinë për Vlora Hysenin/ Tabaku: Shqipëria vuan nga një republikë e të korruptuarve

16:42 : 27/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.